

Vendim nr. 216 datë 30.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 30.07.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 14 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SOKOL PËRMARKAJ

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit së të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si rrjedhojë e mosshqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë brenda afatit 2-mujor, të parashikuar nga neni 435, pika 1, i Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës (*Kushtetuta*); 27, 39, 43, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 69, datë 10.07.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka deklaruar kërkesin fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese kundër dy personave”, në dëm të P.M. dhe H.M., të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79,

shkronja “dh” dhe 25 të Kodit Penal (KP); “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese, në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave”, në dëm të shtetasve T.M., A.M. dhe A.M., e mbetur në tentativë dhe e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 79, shkronja “ë”, 22 dhe 25 të KP-së; “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së. Në aplikim të nenit 55 të KP-së kërkuesi është dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Vendimi i gjykatës së rrethit është lënë në fuqi me vendimin nr. 167, datë 17.04.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2017-641, datë 13.07.2017, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në vijim, përmes kërkesave të ndryshme, kërkuesi ka kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) vendimet e dënimit të gjykatave të zakonshme, vendimet e gjykatave të zakonshme të dhëna për kërkesat e tij për rishikimin e vendimeve të dënimit, si dhe ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të neneve 19, shkronja “o” dhe 112, pikat 1, 2 dhe 3, të vendimit nr. 209, datë 06.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” (*Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve*). Me vendimet nr. 36, datë 15.02.2018, nr. 8, datë 14.01.2022, nr. 111, datë 16.09.2022 dhe nr. 181, datë 15.12.2022, Kolegjet e Gjykatës kanë vendosur moskalimin e çështjeve për shqyrtim në seancë plenare.

2. Gjatë vuajtjes nga kërkuesi të dënimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (*IEVP*), Korçë, punonjësi i policisë së këtij institucioni ka raportuar incidentin e ndodhur në datën 08.08.2023 në mjediset e sektorit të izolimit. Sipas raportit, gjatë shoqërimit të kërkuesit për të dalë në ajrim, ky i fundit ka lagur me ujë kamerën e sigurisë që mbikëqyrte sektorin e veçimit dhe, pasi është ngjitur me shpejtësi në dritaren e parë, ka arritur ta shpëpusë atë nga vendi ku ishte vendosur, duke e thyer. Me urdhrin nr. 2776/1, datë 09.08.2023, drejtori i IEVP-së, Korçë ka urdhëruar nisjen e procedurës disiplinore dhe krijimin e Komisionit Disiplinor. Ky i fundit, pas dëgjimit të kërkuesit dhe shqyrtimit të argumenteve të tij, ka vendosur pezullimin e procedurës dhe referimin e çështjes Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Burgosurve (*KVRRB*). Pas analizës së profilin të kërkuesit dhe të dhënave përkatëse, bazuar në nenin 68, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, KVRRB-ja ka propozuar vendosjen e kërkuesit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë 3-mujore. Ky propozim është pranuar nga drejtori i IEVP-së, Korçë, i cili, me vendimin nr. 2931 prot., datë 18.08.2023, ka vendosur kalimin e kërkuesit në këtë regjim, duke filluar nga data 18.08.2023. Vendimi i drejtorit është pasuar me urdhrin e tij nr. 2932 prot., të po së njëjtës datë. Kërkuesi ka ankimuar gjyqësisht urdhrin në fjalë, duke kërkuar revokimin e tij si antikushtetues e antiligjor.

3. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 41-2024-57 (19/450), datë 10.01.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuarit për revokimin e urdhrit, me arsyetimin se: (i) vendimi nr. 2931/2023 i kishte humbur efektet e tij, ndaj kërkitimi për revokimin e tij mbetet pa objekt, pasi gjykata nuk mund të revokonte një vendim që nuk ishte në fuqi; (ii) kërkuari kishte rrezikuar sigurinë në IEVP, Korçë, duke penguar funksionimin normal të institucionit dhe nxitur të burgosurit e tjerë të mos zbatonin normat e dënimit me burgim, ndaj vendimi mbi bazën e të cilit ishte nxjerrë urdhri ishte i bazuar në ligj e në prova. Kërkuari ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

4. Me vendimin nr. 1871, datë 22.07.2024, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se në vendosjen e kërkuarit nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë IEVP-ja, Korçë kishte vepruar në respektim të procedurave dhe kriterëve ligjore. Në datën 18.12.2024 kërkuari ka ushtruar rekurs ndaj vendimeve të gjykatave të faktit, duke kërkuar, krahas shfuqizimit të tyre, edhe shqyrtimin e rekursit brenda afatit ligjor 2-mujor të parashikuar nga neni 435, pika 1, i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se çështja është regjistruar me nr. 88000-00158-00-2025 të kësaj gjykate dhe është caktuar relatori, ndërkohë që ende nuk është caktuar një datë për shqyrtimin e saj.

5. Në datën 30.05.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 11.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 6.1. *Së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm*, pasi rekursi i tij i është dërguar Gjykatës së Lartë nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 27.12.2024 dhe pavarësisht kalimit të afatit ligjor 2-mujor të parashikuar nga neni 435, pika 1, i KPP-së, ai nuk është shqyrtuar ende.
- 6.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar një standard tjetër në raste të tjera, duke marrë në shqyrtim rekursin brenda afatit ligjor 2-mujor të parashikuar nga dispozita në fjalë.

- 6.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi disa nga kërkesat që i ka drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) janë marrë në shqyrtim nga i njëjti gjyqtar i asaj gjykate.
- 6.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi dhe dispozitivi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë janë kontradiktorë, çka e bën atë vendim të pavlefshëm në kuptim të nenit 383, pika 2, të KPP-së. Edhe pse ka pranuar se është mbajtur në burgim përtej afatit ligjor 3-mujor të përcaktuar në urdhër, gjykata sërish nuk i ka dhënë të drejtë atij. Po kështu, ajo nuk ka përcaktuar nëse kërkuesi është i paraburgosur ose i dënuar, nuk ka arsyetuar nëse ai është mbajtur në regjimin e veçantë në kundërshtim me nenet 25, 27, 28 e 32 të Kushtetutës dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe nëse IEVP-ja, Korçë ka shkelur nenin 17 të kësaj rregulloreje, sipas të cilit i burgosuri qëndron në dhomën e paraburgimit jo më shumë se 10 ditë dhe më pas vendoset në mjedisin e banimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji evidenton se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka parashtruar pretendime si për sa i përket procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat vendase, ashtu edhe procesit të zhvilluar nga GJEDNJ-ja. Për sa i takon këtij të fundit, kërkuesi ka parashtruar njëanshmërinë e gjyqtarëve që kanë shqyrtuar çështjet e tij në atë gjykatë.

9. Neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës parashikon se Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose

vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Kjo dispozitë përcakton se Gjykata ka kompetencë për të shqyrtuar vetëm ato ankesa që, brenda kuadrit të sistemit të drejtësisë shqiptare, prekin të drejtat kushtetuese, ku përfshihen vendimet e gjykatave dhe aktet e organeve shtetërore shqiptare. Në këtë kuptim, Kolegji thekson se një individ nuk mund të përdorë ankimin kushtetues individual si mjet për kundërshtimin e akteve të një institucioni ndërkombëtar, siç është GJEDNJ-ja, e cila ushtron juridiksion të veçantë, të pavarur nga sistemi juridik kombëtar i shteteve anëtare. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit për njëanshmërinë e gjyqtarëve të GJEDNJ-së nuk mund të merren në shqyrtim, pasi nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës.

10. Për sa u përket pretendimeve të tjera, të cilat parashtrohen në lidhje me procesin gjyqësor të gjykatave vendase të zhvilluar në kuadër të masës së caktuar ndaj tij gjatë vuajtjes së dënimit në IEVP-në, Korçë, konkretisht regjimit të veçantë të mbikëqyrjes, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në atë proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 83, datë 05.12.2024; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, në ankimin kushtetues individual kërkuari ka parashtruar pretendime si ndaj procesit të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë për revokimin e urdhrin të drejtorit të IEVP-së, Korçë, ashtu edhe ndaj tejzgjatjes së shqyrtimit të rekursit të tij nga Gjykata e Lartë. Për sa u përket pretendimeve për procesin e zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë, të parashtruara në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji evidenton se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e ushtruar nga kërkuari. Për rrjedhojë, për sa kohë që nuk ka një vendim përfundimtar për të, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pretendimet për këtë vendim nuk mund të merren në shqyrtim, pasi për to kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

13. Për sa i përket pretendimit për tejzgjatjen e shqyrtimit të rekursit të tij nga Gjykata e Lartë, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar se ai nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor 2-mujor të parashikuar nga neni 435, pika 1, i KPP-së, çka i ka cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit.

14. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Kolegji vë në dukje se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave (nenet 399/4 dhe 399/6), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (shih vendimet nr. 9, datë 04.03.2025; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Në këndvështrim të këtyre standardeve, në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ndonjë akt që të provojë se ka përdorur mjetet ligjore të parashikuara nga dispozitat e mësipërme dhe nuk ka parashtuar shkaqe për mungesën e efektivitetit të tyre. Kolegji vëren gjithashtu se pretendimet për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit parashtrohen nga kërkuesi në kuadër të shqyrtimit të rekursit brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 435, pika 1, i KPP-së. Në kushtet kur vlerësimi i pretendimeve për tejzgjatjen e shqyrtimit të rekursit i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme, Kolegji sjell në vëmendje se në kërkesën për cenimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit kërkuesi mund të parashtrojë edhe pretendimet e tij për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të rekursit dhe për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, edhe këto pretendime të tij nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.